



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8396 /2018
Data: 08.10.2018

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2018 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 18.09.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkryetar i Komunës), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për transparencë), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i projekt-buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2020-2021 për komunën e Hanit të Elezit.
3. Shqyrtimi i plotësimit dhe ndryshimit të statutit të komunës .
4. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.
5. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të kompanisë publike lokale për mbeturina.
6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i projekt-buxhetit për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2020-2021 për komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- dëgjimet publike janë mbajtur për buxhetin dhe sipas qarkoreve buxhetore buxheti i përgjithshëm i Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019 është në shumë prej 2,915,921 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2020 janë në shumë prej 2,625,530 € dhe për vitin 2021 janë në shumë prej 2,717,700 €. Mjetet nga grantet qeveritare janë në shumë prej 2,600,554 €, që shënojnë pjesëmarrje prej 89.18% nga të hyrat vetanake komunale në shumë prej 289,129 € apo 9.92%, ndërsa financimi nga huamarrjet në shumë prej 26,238 € apo 0.90%. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin 2019 sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve parashikohen të kenë këto ndarje buxhetore: paga dhe mëditje 1,493,148 €, mallra dhe shërbime 263,236 €, shpenzime komunale 54,400 €, subvencione dhe transfere 61,104 € dhe shpenzime kapitale 1,044,043 €. Të bashkangjitur keni edhe tri tabelat buxhetore dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Nora Xhoni thekson:- kërkoj sqarim për projektin ndërtimi murit mbrojtës në rrugën brigada 164.

Akif Shkreta thekson:- buxheti për vitin 2019 është në shumë prej 2,915,921 €, ndërsa parashikimet buxhetore për vitin 2020 janë në shumë prej 2,625,530 € dhe për vitin 2021 janë në shumë prej 2,717,700 €, Kërkoj sqarim pse është kjo rënie dhe në vitin 2021 është një ngritje. Kam dëgjuar disa informacione se kompania “Bektelenka” ka një projekt për rregullimin e shtratit Lepenc.

Samire Curri thekson:- kërkoj sqarim rreth hulumtimit të ujit për fshatrat Gorancë, Seçishtë dhe Paldenicë.

Mehmet Ballazhi thekson:- sa pjesëmarrës prej qytetarëve kanë marr pjesë në dëgjime publike dhe a ka pas propozime.

Mallzum Qajani thekson:- muri mbrojtës në fshatin Seçishtë është një projekt që na përcjellë vite me radhë dhe është në rrugën që shkon për Seçishtë. Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc nga kompania “Bektelenka” nuk di në detale se çka do të bëhet dhe nëse rregullohet nga “Bektelenka” shumë pak e përfshinë sipërfaqen e Hanit të Elezit. Jemi në kontakte me Ministrinë e Ambientit që edhe ata të na ndihmojnë me mjete financiare për rregullimin e lumit Lepenc dhe nëse na përkrahin mund të rregullohet brenda dy apo tre viteve. Sa i parkete ndryshimeve buxhetore rregullorja që ua shtonë buxhetin komunave të vogla përfundon në vitin 2019 dhe në vitin 2020 bien buxheti për shkak se ajo rregullore nuk është në fuqi.

Refet Kalisi thekson:- sa i përket shpimit të puseve nëpër fshatra e kemi shpall tenderin dhe mendojmë që edhe në fshatin Paldenicë duhet të bëjmë shpimi e pusit.

Shabi Rexhallari thekson:- ka qenë një kontigjencë e ligjit për financat e pushtetit lokal për tri vite me përfituar katërmbëdhjetë komuna të cilat janë nën njëzet e dy mijë banorë që në atë raste edhe ne si komunë kemi përfituar për periudhën 2017-2019. Në vitin 2020 nuk e kemi shumë sikur se në tri vitet më parë dhe kjo mund të bëhet vetëm nëse ndryshon Ligji. Të planifikuara i kemi pas pesë dëgjime buxhetore dhe prej të cilave tri janë mbajtur dhe dy nuk janë mbajtur. Nga tre dëgjimet buxhetore në secilin numri i pjesëmarrësve ka qenë pesëmbëdhjetë deri njëzetë qytetarë, kurse në fshatin Seçishtë dhe Gorancë nuk janë mbajtur dëgjimet buxhetore. Nga banorët ka pas kërkesa për rregullime të kanalizimeve dhe shtrim të rrugicave me kubza betoni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA PROJEKT BUXHETI PËR VITIN 2019 DHE PARASHIKIMET BUXHETORE PËR VITET 2020-2021 PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i plotësimit dhe ndryshimit të statutit të komunës .

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në plotësimin dhe ndryshimin e statutit të komunës është bërë një ristrukturim dhe ndryshimet që bëhen janë te kompania publike, te komitete konsultative dhe nuk ka ndonjë ndryshim shumë të madh nga statuti i përparshëm por më shumë është ristrukturim.

Akif Shkreta thekson:- emrat e fshatrave janë zyrtare dhe më duket se janë mirë por kjo bien në kundërshtim me institucionet tjera si arsimore, shëndetësore sepse diku shënon Burim , Dremjak, Rezanë, Guranë . Mendoj që nga këtu duhet të bëhen ndryshimet euforike të pas luftës .

Mallzum Qajani thekson:- këto vendbanime në komunën tonë kështu kanë qenë të emërtuara edhe në statutin e më parshëm dhe këto emërtime që i kemi bërë me një herë pas luftës janë bartur në disa institucione por parimisht duhet të thirremi në emërtimet zyrtare të cilat janë dokumente zyrtare.

Bajrush Laçi thekson:- para se me hyjë në statut këto janë në Ligj për shkak se Ligji për kufijtë administrativ i ka përcaktuar fshatrat dhe në bazë të ligjit në fjalë janë të përcaktuara. Ligji kur është bërë ka pas disa gabime te fshati Neçafcë, Seçishtë dhe Vërtomicë por kemi kërkuar me u ndryshuar dhe është ndryshuar.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA PLOTËSIM NDRYSHIMI I STATUTIT TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND.

4. Shqyrtimi i planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019.

Kryesuesi thekson:- kuvendi ka marr vendim për themelimin e komisionit për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2019 dhe komisioni ka mbajtur takim për këtë çështje. Në takimin që kemi pas ekzekutivi i komunës ka kërkuar që tri pika të rendit të punës të hiqen nga plani për vitin 2019. Pika e rendit të punës informatë e progresit të adresimit të rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimtari që është planifikuar të diskutohet në janar drejtorja për buxhet dhe financa propozon me u hequr me arsyetim se nuk kemi auditorë të brendshëm dhe sy drejtori nuk mundemi me përgatitë material për me diskutuar në kuvend. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:-në mbledhje të kuvendit kemi marr vendim për me hartuar planin zhvillimorë komunal dhe jemi në fazë të hartimit që do të zgjatë edhe vitin e ardhshëm dhe nuk mundemi me monitoruar dhe për atë kërkojmë që të hiqet.

Mehmet Ballazhi thekson:- është e vërtetë që nuk e ka obligim drejtorja për buxhet dhe financa me përgatitë material për diskutim për atë pikë të rendit të punës por me gjithë atë ne duhet t'i kemi apo të kalon në kompetencë të kryetarit të komunës apo të përcaktohet një zyrtarë nga komuna për me dhënë informacion. Mendoj se të gjithë pajtohen që komuna ta ketë një auditorë të brendshëm që ai ta ketë përgjegjësinë. Kjo çështje është e mangët sepse vjen auditori dhe bënë auditimin kurse ne nuk i kemi këto informacion për pikët e rendit të punës për të cilën kërkojmë me u hequr nga plani për vitin 2019. Deri sa të miratohet plani zhvillimorë duhet të jetë për diskutim raporti monitorues për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave nga PZHK, PU dhe PRR për vitin paraprak.

Akif Shkreta thekson:- në plan është paraparë informata për fillimin e vitit të ri shkollorë dhe përfundimin e vitit shkollorë dhe mendoj se tash ka ndryshuar qasja sepse është me periudha. Është mirë që shikohet kjo çështje.

Menduh Vlasi thekson:- kam dashur me bërë propozim me hekë nga plani , mirëpo në Paldenicë dhe në Gorancë nuk i kemi me kurikulë. Do t'i analizoj dhe për mbledhje të kuvendit dhe nëse janë të arsyeshme do të propozoj në mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Shqyrtimi i propozim vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të kompanisë publike lokale për mbeturina.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mallzum Qajani thekson:- në bazë të udhëzimeve administrative bordi i aksionarëve duhet ët zgjidhet nga kuvendi i komunës pasi që kuvendi është themelues kompanisë publike lokale për mbeturina dhe duhet që komisionin të përbëhet nga anëtarët dy prej kuvendit të komunës dhe një përfaqësuesi i kryetarit të komunës. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Bajrush Laçi thekson:- me që ligjin nuk ka ndryshuar dhe potencon që një anëtarë e përcakton kryetari i komunës kurse dy anëtarë të tjerë duhet të nga radhët kuvendi të komunës.

Kryesuesi thekson:- partitë politike emrat duhet t'i paraqesin në kuvend për këtë çështje. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 4 për 1 abstenim, (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT TË AKSIONARËVE TË KOMPANISË PUBLIKE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi fillimin e vitit të ri shkollor 2018/2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- të gjitha informacionet rreth fillimit të vitit të ri shkollorë 2018/2019 i kemi paraqit në informatë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni


Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

U VOTUA INFORMATATA MBI FILLIMIN E VITIT TË RI SHKOLLOR 2018/2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

Mbledhja përfundoi në ora 12:30 ju faleminderit për pjesëmarrje.

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit

MSc. Qamush Brava

